

Specialist Shitje

TRAININGS
RECRUITMENTS
CONSULTANCY

eppc

HUMAN RESOURCES TRAININGS FINANCIAL MANAGEMENT

eppc kërkon një **Specialist/e shitje** për klientin e saj, një kompani solide, dinamike dhe inovative, ndër kompanitë më me emër në vend në fushën e veprimtarive ku operon, si: Ndriçues; Hidrosanitare, Hidraulike.

Qëllimi kryesor i punës:

Puna e Specialistit të shitjes, konsiston në ofrimin e shkëlqyer të shërbimit ndaj klientëve, shitjen e produkteve dhe shërbimeve, ndjekjen e proceseve të punës siç është e përcaktuar në udhëzimet e shitjeve dhe politikave të kompanisë, kryerjen e aktiviteteve të shitjes me qëllim përmbushjen e nevojave të klientit dhe arritjen e objektivave të paracaktuara të shitjes.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Eksperiencë të mëparshme në fushën e shitjeve (*eksperienca në Retail përbën avantazh*);
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi dhe shitjeje;
- Paraqitje profesionale dhe të jetë i/e orientuar drejt shërbimit ndaj klientit dhe arritjes së objektivave;
- Të jetë person energjik, pozitiv dhe i/e motivuar (preferohet grupmosha 25-30 vjeç);
- I/e gatshme të punojë me turne për 6 ditë në javë;
- Njohuri të mira kompjuterike për prerjen e faturave dhe përpilimin e ofertave.

Të dhënat:

Pozicioni:	Specialist shitjeje;
Vendndodhja:	Tiranë;
Orari:	6 ditë në javë;
Raporton tek:	Manaxheri i dyqanit;
Pagesa:	Në varësi të aftësive të kandidatit/es;
Kontrata:	Sipas Kodit të Punës;
Aplikimet mbyllen:	12 Maj 2017.

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke **përmendur pozicionin për të cilin aplikoni** në adresën e e-mail-it:

recruitments@eppc.al

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen.